

në SPB-në e Gjilanit/Gnjilane. Në datën **19.05.1998**, Dejana me axhën e vet u nisën nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica për në Pejë/Peć, me një linjë të rregullt autobusi. Atje, ai u takua me të vëllain. Po atë ditë, me autobus u nis për në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Derisa po kalonin nëpër **Vojnikë/Voćnjak**, një grup i anëtarëve të UÇK-së e ndali autobusin. Katër ushtarët e armatosur të UÇK-së kanë hyrë brenda dhe e kanë nxjerr Dejanin jashtë autobusit. E çuan në drejtim të panjohur. Ka indikacione që Dejana mbahej në burgun e UÇK-së në **Likoc/Likovac**. Fati i tij është i panjohur edhe sot e kësaj dite. Në regjistrin e të zhdukurve, i cili administrohet nga KNKK-ja, rasti i tij është sistemuar në lëndën me numër YUK-050055-01.

**Burimet:** deklarata D.M, FDH-601; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 168, FDH-23816; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; Z. Stijović, *Kosmet...*, 120; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 363; *Izveden iz autobusa*, Oteta istina num. 20, tetor-dnjetor 2009, 26, FDH-29301; Video snimak iz logora na Kosovu glavni dokaz protiv Tačija, Blic, 24.12.2010, <http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/225643/Video-snimak-iz-logora-na--Kosovu-glavni-dokaz-protiv-Tačija>; *Poslednji vapaj otetih Srba*, Večernje Novosti, 24.1.2011, [Http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/aktuelno.69.html:316342-Poslednji-vapaj-otetih-Srba](http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/aktuelno.69.html:316342-Poslednji-vapaj-otetih-Srba).

## Fatmir (Xhemajl) Sahiti

(4.02.1971, shqiptar nga Kopiliqi i Ulët/Donji Obilić, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Fatmiri me prindërit Xhemajlin dhe Sylhanen, si dhe vëllezerit Fatonin dhe Basriun, jetonin në Kopiliqin e Ulët/Donji Obilić. Në mëngjes, më **30.05.1998**, Fatmiri ka shkuar te shtëpia e bashkëfshatarit Musli Tahiraj, ku shtabi lokal i UÇK-së i mban-te takime të veta. Rreth orës 10:00, forcat serbe i nisën granatimet e fshatit nga drejtimi i fshatit fqinj të Turiqecit/Turićevac. Një granatë ka eksploduar në afërsi të Fatmirit dhe e ka plagosur rëndë në kraharor [**Kopiliq i Ulët/Donji Obilić**]. Familjarët e kanë bartur në spitalin e UÇK-së në Likoc/Likovac. Fatmiri ka ndërruar jetë pas gjysmë ore. E kanë varrosur një ditë më

vonë në Kopiliqin e Ulët/Donji Obilić. Pas lufte, në muajin shtator të vitit 1999, mbejtjet e tij mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshatin e lindjes.

**Burimet:** deklarata S.S, FDH-18182; deklarata J.S, FDH-32020; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816.

## Agim (Emin) Emini

(1963, shqiptar nga Turiqeci/Turićevac, komuna e Skënderajt/Srbica, blegtor, i martuar)

Agimi me bashkëshorten dhe familjen e të vëllait Bajramit jetonin në *Mëhallën Ali* në **Turiqec/Turićevac**. Rreth orës 9:00, në mëngjesin e datës **31.05.1998**, ata i kanë dëgjuar krismat e armëve nga drejtimi i fshatit Burojë/Broćna, ndërkaq, pas pak, në fshat filluan të hynin pjesëtarë të forcave serbe. Agimi dhe djali i vëllait të tij, Florimi, e braktisën fshatit dhe shkuan drejt *Bjeshkëve të Toplicës/Topličke planine*. Shumica e burrave ishin strehuar atje më herët. Përderisa shkonin në bjeshkë, Agimi e ndërroi mendjen dhe vendosi që të kthehej që tu ndihmonte grave dhe fëmijëve. Sapo i kaloi afro 30 metra, e qëlluan për vdekje. Florimi ka dëgjuar britmën e Agimit dhe, më pas, e ka parë të binte në tokë. Në mbrëmje, Bajrami me të afërmit e vet e sollën trupin e Agimit në fshat. Një ditë më vonë, e kanë varrosur në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata F.E, FDH-17331; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 58, FDH-23857; fotografi, FDH-19117.

## Blagoje (Rajko) Jovanović

(22.02.1944, serb nga Kostërci/Kostrc, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, tre fëmijë)

Blagoje me bashkëshorten Živkën dhe djalin Zvonkon kanë qenë serbët e vetëm në Kostërc/Kostrc. E çonin mirë me komshinjtë shqiptar. Jetonin nga bujqësia. Në muajin mars to vitit 1998, Zvonko ka shkuar në kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak. Në datën 5.06.1998, Blagoje dhe Živka kanë vërejtur se të gjithë shqiptarët e kishin braktisur **Kostërcin/Kostrc**. Për këtë arsye, edhe ata morën vendim që të kalonin te farefisi në fshatin fqinj të Runi-